



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr. 11, datë 10.07.2024

**“Për përfaqësimin e institucioneve të drejtësisë me përfaqësues/ekspertë/profesionistë
pranë Grupit të Ekspertëve dhe Sekretariatit Teknik në Komisionin e Posaçëm
Parlamentar”**

Bazuar në nenet 24 dhe vijues, të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën VIII të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. T’u drejtohet me një “Ftesë për bashkëpunim” të gjithë institucioneve dhe organeve, pjesë të sistemit të drejtësisë dhe që ushtrjnë funksione në fushën e drejtësisë (sipas listës 1 bashkëlidhur), që të propozojnë përfaqësuesit e tyre me të cilët do të përfaqësohen për të asistuar dhe kontribuar në veprimtaritë që do të zhvillohen nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar.
2. Të ftojë, gjithashtu, institucionet e lartpërmendura, që të propozojnë ekspertët e tyre më të mirë, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, pedagogëve etj, të cilët do të krijojnë nëngrupin e ekspertëve pranë Grupit të Ekspertëve (GE), strukturë e cila do të angazhohet me hartimin e analizës për sundimin e ligjit në fushën e drejtësisë, hartimin e Planit përkatës të Veprimit, si dhe do të sugjerojë propozimet për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale që do të propozohen Komisionit të Posaçëm Parlamentar, për shqyrtim e miratim. Në mbështetje të punës së ekspertëve, institucionet ftohen të propozojnë nga radhët e stafit, këshilltarëve dhe asistentëve të tyre, profesionistë që do të krijojnë nëngrupin e punës përkatës të ngritur pranë Sekretariatit Teknik.
3. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t’u komunikuar institucioneve të përmendura sipas pikës 1 më sipër, vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin dhe kohën e veprimtarisë së tij si dhe kriteret e cilësitë e domosdoshme që duhet të përmbushin përfaqësuesit/ekspertët/profesionistët e tyre për t’u përfshirë në këtë proces.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar më 10.07.2024

KRYETAR

Fatmir KHAF AJ

LISTA 1

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ);
2. Gjykata e Lartë;
3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP);
4. Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK);
5. Prokuroria e Përgjithshme;
6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD);
7. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED);
8. Shkolla e Magjistraturës;
9. Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA).